

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Qendra e Formimit Profesional Publik _____

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË
“KUJDESTAR FËMIJËSH”

Kodi: KF-24

Miratoi:

DREJTOR

.....

2024

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“KUJDESTAR FËMIJËSH”

(KF-24)

I. Profili Profesional i Kujdestarit të fëmijëve

a) Karakteristikat e Kujdestarit të fëmijëve

Kujdestari i fëmijëve është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar apo i vetëpunësuar në mjedise shtëpiake të familjeve të interesuara për kujdesin ndaj fëmijës së tyre, në çerdhe private, ose mund të krijojë vetë një mjedis shtëpiak për mbajtjen e fëmijëve të familjeve të interesuara.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe **shprehi** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të kujdestarit të fëmijëve.

Suksesi i kujdestarit të fëmijëve është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj, sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e Kujdestarit të fëmijëve

Profesioni i kujdestarit të fëmijëve është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për perkujdesjen ndaj fëmijëve të moshave 0-6 vjeç, në mjedise familjare dhe në biznese private. Ai mund të punësohet në biznese private që ofrojnë shërbime të kujdesit të fëmijëve për moshat 0-6 vjeç. Gjithashtu, ai mund të vetëpunësohet si kujdestar fëmijësh. Kujdestari i fëmijëve mund të krijojë biznesin e tij në këtë sektor dhe të krijojë mundësi punësimi për të tjerë.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e mësuesit parashkollor. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkolla apo trajnimit nëpërmjet punës, një kujdestar fëmijësh mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si, kujdestar çerdheje apo kujdestar kopshti.

Ndjekja e shkollës së lartë për “Arsim Parashkollor” çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e mësuesit parashkollor.

Për të zhvilluar aktivitetet privat dhe për vetëpunësim në veprimtarinë e kujdesit të fëmijëve, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit. Ky kurs i përkatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësitet “Kujdestar Fëmijësh” me kod 5311.01, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Kujdestar fëmijësh”

Në përfundin të Kursit për “Kujdestar fëmijësh”, kursantët do të jenë të aftë të:

- identifikojnë format e abuzimit ndaj fëmijëve;
- zhvillojnë te fëmijët, aftësitë e tyre lëvizore dhe shoqërore;
- mbështesin përmbushjen e nevojave edukative të fëmijëve;
- kujdesen për veshjen e fëmijëve;
- garantojnë higjienën e fëmijëve dhe mjedisit ku jetojnë;
- të mbrojnë fëmijët nga rreziqet e ndryshme;
- kryejnë ushqyerjen e fëmijëve;
- kujdesen për fjetjen e fëmijëve;

- parandalojnë dëmtimin e fëmijëve nga rreziqet dhe sëmundjet e ndryshme;
- japin ndihmën e parë në raste dëmtimesh dhe sëmundjesh të fëmijët;
- ndiekin procesin e zhvillimit psikomotor dhe shoqëror të fëmijëve;
- kujdesen për zhvillimin e fëmijëve e nevoja të veçanta;
- zbatojnë procesin e gjithëpërfshirjes;
- respektojnë të drejtat individuale të fëmijëve;
- respektojnë konfidencialitetin e familjeve për fëmijët e të cilave kujdesen;
- të zbatojnë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë;
- të zbatojnë rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Kujdestar fëmijësh”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Kujdestar fëmijësh” duhet të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Kujdestar fëmijësh”.

240 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Kujdestar fëmijësh”

Nr.	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënërit
1	Hyrje në profesionin e kujdestarit të fëmijëve	KF-01-24	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kujdestarit të fëmijëve. 2. Kursanti përshkruan Konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve. 3. Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit me fëmijët dhe prindërit. 4. Kursanti përshkruan format e abuzimit ndaj fëmijëve.
2	Veshja dhe higjiena e fëmijës	KF-02-24	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan rregullat e higjienës për kujdesin ndaj fëmijëve. 2. Kursanti zbaton rregullat e higjienës gjatë kujdesit për fëmijë. 3. Kursanti përshkruan veçoritë e veshjes së fëmijëve. 4. Kursanti kujdeset për veshjen e fëmijëve.
3	Ushqyerja e fëmijëve	KF-03-24	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e ushqyerjes së fëmijëve. 2. Kursanti ushqen fëmijët.

4	Fjetja e fëmijëve	KF-04-24	15 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e fjetjes së fëmijëve. 2. Kursanti përkujdeset për fjetjen e fëmijëve.
5	Mbrojtja e fëmijëve nga sëmundjet dhe rreziqet e mundshme	KF-05-24	50 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan rreziqet ndaj fëmijëve dhe masat mbrojtëse përkatëse. 2. Kursanti parandalon rreziqet te fëmijët dhe jep ndihmën e parë. 3. Kursanti përshkruan simptomat e sëmundjeve më të shpeshta të fëmijëve. 4. Kursanti jep ndihmën e parë për sëmundjet e shpeshta të fëmijëve.
6	Zhvillimi dhe edukimi i fëmijëve	KF-06-24	60 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan procesin e zhvillimit psikomotor dhe shoqëror të fëmijëve. 2. Kursanti përshkruan rëndësinë që ka edukimi i shëndetshëm tek fëmijët. 3. Kursanti menaxhon rastet e bullizmit në zhvillimin e fëmijëve. 4. Kursanti organizon lojra për zhvillimin e fëmijëve.
7	Zhvillimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.	KF-07-24	35 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kujdeset për zhvillimin e fëmijëve me çrregullim hiperaktiviteti. 2. Kursanti kujdeset për zhvillimin e fëmijëve me spektrin e autizmit. 3. Kursanti kujdeset për zhvillimin e fëmijëve me sindromën 'down'. 4. Kursanti menaxhon procesin e gjithëpërfshirjes te fëmijët.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e kursit për të gjitha rezultatet e të nxënit (RN-të) që përmbajnë të gjitha modulet e kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MEKI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Kujdestar fëmijësh”:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e kujdestarit të fëmijëve”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E KUJDESTARIT TË FËMIJËVE	KF-01-24
Qëllimi i modulit	Një modul teorik, që njeh kursantët me mjedisin e punës, veçoritë dhe kërkesat e profesionit të kujdestarit të fëmijëve, me të drejtat e fëmijëve 0-6 vjeç, rregullat e komunikimit si dhe format e abuzimit ndaj tyre, njohuri që lehtësojnë përvetësimin e kompetencave të punës në këtë profesion.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kujdestarit të fëmijëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë qëllimin, rëndësinë e kujdestarit të fëmijëve; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës; - të përshkruajë mjedisin, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës; - të përshkruajë proceset bazë të veprimtarisë së kujdestarit të fëmijëve; - të përshkruajë marrëdhënien e kujdestarit të fëmijëve me fëmijët dhe familjarët; - të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e veprimtarisë së kujdestarit të fëmijëve; - të përshkruajë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë; - të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë RN 2 Kursanti përshkruan Konventën e të drejtave të fëmijëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të përshkruajë Konventën e të drejtave të fëmijëve; - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për të jetuar;	

-
- të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për të patur mbrojtje shëndetësore;
 - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për t'u edukuar;
 - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për të patur familje;
 - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për t'u mbrojtur ndaj racizmit dhe çdo forme tjetër diskriminimi;
 - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për t'u mbrojtur ndaj çdo forme neglizhence, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi;
 - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për t'u mbrojtur nga lufta dhe privimi i lirisë;
 - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për të patur identitet kulturor e fetar;
 - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për t'u shprehur;
 - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për të jetuar;
 - të përshkruajë të drejtën e fëmijëve për t'u mbrojtur nga lufta dhe privimi i lirisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- RN 3**
- Pyetje - përgjigje me gojë
 - Pyetje - përgjigje me shkrim

Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit me fëmijët dhe prindërit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë karakteristikat e një kujdestari të mirë;
- të përshkruajë mënyrat e komunikimit me fëmijët;
- të përshkruajë format e komunikimit të kujdestarit me fëmijët;
- të përshkruajë kujdesin ndaj përdorimit të fjalëve të papërshtatshme me fëmijët;
- të përshkruajë mjetet e tjera të komunikimit me fëmijët si, gjuha e gjesteve etj.;
- të përshkruajë tërë rregullat e komunikimit me fëmijët;
- të përshkruajë komunikimin me fëmijët në përshtatje me temperamentin dhe moshën e tyre;
- të përshkruajë ambientin e çerdhës dhe përshtatjen e fëmijëve në të;
- të përshkruajë përparësitë e çerdhës;
- të përshkruajë format e komunikimit të kujdestarit me prindin.

RN 4 ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Kursanti përshkruan format e abuzimit ndaj fëmijëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rastet e ndryshme të keqtrajtimit fizik të fëmijëve (rrahja, mos-ushqyerja, braktisja, mos-

-
- veshja, izolimi, abuzimi seksual, etj.).
- të përshkruajë raste të keqtrajtimit psikologjik të fëmijëve (trembja, kërcënimi, etj.);
 - të shpjegojë pasojat e keqtrajtimit fizik dhe psikik te fëmijët;
 - të tregojë mënyrat e reagimit ndaj keqtrajtimeve të fëmijëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra, si: të përshkruajnë veçoritë e profesionit të kujdestarit të fëmijëve. - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedisë reale të punës. - Komplet i materialeve, pajisjeve dhe instrumenteve të punës. Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve.

2. Moduli “Veshja dhe higjiena e fëmijës”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VESHJA DHE HIGJIENA E FËMIJËS	KF-02-24
Qëllimi i modulit	Një modul që njeh kursantët me rregullat e higjienës dhe veçoritë e veshjeve të fëmijëve 0-6 vjeç, si dhe aftëson për të garantuar higjienën e fëmijëve dhe realizuar veshjen dhe zhveshjen e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e kujdestarit të fëmijëve”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan rregullat e higjienës për kujdesin ndaj fëmijëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë e higjienës tek fëmijët; - të tregojë se si mbahet pastër mjedisi ku jetojnë fëmijët; - të tregojë se si mbahet pastër vetë kujdestari i fëmijëve; - të tregojë si mbahen pastër fëmijët; - të përshkruajë si kryhen banjot e fëmijëve; - të përshkruajë veshjet e brëndshme të fëmijëve (bebelinat); - të tregojë se si krijohen te fëmijët, shprehitë për të respektuar rregullat e higjienës. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim	
	RN 2 Kursanti zbaton rregullat e higjienës gjatë kujdesit për fëmijët. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të krijojë një mjedis të pastër për fëmijët; - të zbatojë rregullat për mbajtjen pastër të fëmijëve; - të zbatojë rregullat për mbajtjen pastër të vetvetes (kf); - të nxitë fëmijët për të qënë të pastër; - të kryejë banjo të pjesshme të fëmijëve; - të kryejë banjo të plota të fëmijëve; - të ndërrojë bebelinat e fëmijëve; - të praktikojë fëmijët për kryerjen e veprimeve higjienike dhe vet-kontrollin e akteve të jashtëqitje; - të zbatojë rregullat e higjienës. Instrumentet e vlerësimit:	

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Kursanti përshkruan veçoritë e veshjes së fëmijëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të argumentojë rëndësinë e veshjeve të fëmijëve;
- të përshkruajë kujdesin gjatë procesit të veshjes dhe zhveshjes së fëmijëve;
- të tregojë veçoritë e veshjeve sipas moshës dhe stinës;
- të argumentojë rëndësinë e estetikës së veshjes së fëmijëve;
- të tregojë mënyrat e krijimit të shprehive të fëmijët për vet-veshje dhe vet-zhveshje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RN 4 Kursanti kujdeset për veshjen e fëmijëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të për zgjedhë veshjet e përshtatshme të fëmijëve;
- të veshë fëmijët sipas moshës dhe veshjes përkatëse;
- të zhveshë fëmijët sipas moshës dhe veshjes përkatëse;
- të mësojë fëmijët për t'u veshur vetë;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe higjienës;
- të zbatojë rregullat e komunikimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime të kujdesit për fëmijëve.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra, si: të realizojë garantimin e higjienës dhe realizimin e veshjes dhe zhveshjes së fëmijëve. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës.
 - Mjetet e nevojshme për garantimin e higjienës së fëmijëve.

-
- Veshje për fëmijë të moshave 0-6 vjeç.
 - Komplet i materialeve, paisjeve dhe instrumenteve të punës.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Ushqyerja e fëmijëve”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	USHQYERJA E FËMIJËVE	KF-03-24
Qëllimi i modulit	Një modul, që njeh kursantët me rolin e ushqimit dhe me veçoritë ushqyerjes së fëmijëve 0-6 vjeç, si dhe aftëson ata për të garantuar zhvillimin e një procesi normal të ushqyerjes së fëmijëve.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet: “Hyrje në profesionin e kujdestarit të fëmijëve” dhe “Veshja dhe higjiena e fëmijës”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e ushqyerjes së fëmijëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë dhe vlerat e ushqyerjes; - të përshkruajë rëndësinë e piramidës ushqimore; - të shpjegojë pesë grupet ushqimore; - të argumentojë përshtatjen e ushqimeve me moshën e fëmijës; - të përshkruajë kushtet e ruajtjes së vlerave ushqimore; - të përdorë mjetet për ushqyerjen e fëmijëve; - të tregojë mënyrat e kujdesit ndaj mjeteve për ushqyerjen e fëmijëve. - të përshkruajë vështirësitë gjatë ushqyerjes së fëmijëve. - të shpjegojë si respektohet regjimi i ushqyerjes tek fëmijët; - të tregojë mënyrat e komunikimit gjatë ushqyerjes; - të përshkruajë aktivitete me fëmijët për të nxitur ushqyerjen e tyre; - të përshkruajë pasojat që sjell ushqyerja jo e mirë gjatë fëmijërisë; - të përshkruajë rreziqet gjatë ushqyerjes; - të shpjegojë përfshirjen e fëmijëve në përgatitjen e ushqimit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim	

RN 2 Kursanti ushqen fëmijët.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë fëmijën për t'u ushqyer;
- të përgatitë ushqimin për fëmijët;
- të përdorë mjetet për ushqyerjen e fëmijëve;
- të ndajë sasinë e nevojshme të ushqimit për të cilën fëmija ka nevojë në varësi të moshës;
- të tregojë mënyrën e mbajtjes dhe pozicionet e qëndrimit të fëmijës gjatë ushqyerjes;
- të kryejë ushqyerjen e fëmijës;
- të kryejë aktivitete me fëmijët për të nxitur ushqyerjen për fëmijët;
- të kryejë veprimet e nevojshme pas ushqyerjes së fëmijëve;
- të shpjegojë rëndësinë e futjes në menu, të ushqimeve të reja për fëmijën;
- të tregojë mënyrën e nxitjes së fëmijëve për vet-ushqyerje;
- të përshkruajë metodat e përdorura tek fëmija, për respektimin e rregullave gjatë ngrënies;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe higjienës;
- të zbatojë rregullat e komunikimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime të përkujdesjes për fëmijët.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra, si: të kryejnë demonstrimet konkrete për realizimin e ushqyerjes normale, përdorimin e mjeteve dhe ushqimeve për fëmijët.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
domosdoshme për
realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Mjetet e nevojshme për përgatitjen e ushqimeve dhe ushqyerjen e fëmijëve.
 - Produktet ushqimore për fëmijët ë moshës 0 – 6 vjeç.
 - Kompletet e materialeve, paisjeve dhe instrumenteve të punës.
-

4. Moduli “Fjetja e fëmijëve”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	FJETJA E FËMIJËVE	KF-04-24
Qëllimi i modulit	Një modul, që njeh kursantët me veçoritë e fjetjes së fëmijëve 0-6 vjeç, si dhe aftëson ato për të garantuar një fjetje normale të fëmijëve.	
Kohëzgjatja e modulit	15 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet: “Hyrje në profesionin e kujdestarit të fëmijëve”, “Veshja dhe higjiena e fëmijës” dhe “Ushqyerja e fëmijëve”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e fjetjes së fëmijëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë fenomenin e gjumit; - të përshkruajë fazat e gjumit dhe vlerat e tij; - të argumentojë nevojat për gjumë; - të përshkruajë veçoritë e regjimit të fjetjes së fëmijëve sipas grupmoshave; - të tregojë kushtet e nevojshme për garantimin e një fjetjeje të rehatshme; - të tregojë mënyrat e komunikimit me fëmijët para fjetjes - të përshkruajë rastet e veçanta gjatë gjumit (trembjen, urinimin, etj.). Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim RN 2 Kursanti përkujdeset për fjetjen e fëmijëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të parapërgatitë një mjedis të përshtatshëm për fjetjen e fëmijëve; - të përgatitë fëmijët për fjetje; - të vërë në gjumë fëmijët; - të vëzhgojë fëmijët gjatë gjumit; - të përkujdeset për fëmijët pas zgjimit; - të zbatojë rregullat e sigurisë dhe higjienës; - të zbatojë rregullat e komunikimit. Instrumentet e vlerësimit:	

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime të përkujdesjes për fëmijët. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra, si: të tregojnë kushtet për fjetjen e fëmijëve, të kryejnë demonstrimet konkrete për vënien në gjumë të fëmijëve, si dhe përkujdesjen e tyre. - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise dhe materialet e nevojshme për garantimin e fjetjes normale të fëmijëve. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli “Mbrotjtja e fëmijëve nga sëmundjet dhe rreziqet e mundshme”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MBROJTJA E FËMIJËVE NGA SËMUNDJET DHE RREZIQET E MUNDSHME	KF-05-24
Qëllimi i modulit	Një modul, që aftëson kursantët të identifikojnë sëmundjet më të shpeshta që kërcënojnë fëmijët, simptomat e tyre, masat për parandalimin, si dhe të japë ndihmën e parë në raste të tilla.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori; 60% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet: “Hyrtje në profesionin e kujdestarit të fëmijëve”, “Veshja dhe higjiena e fëmijës”, “Ushqyerja e fëmijëve” dhe “Fjetja e fëmijëve”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan rreziqet ndaj fëmijëve dhe masat mbrojtëse përkatëse. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë masat pandaluese dhe pasojat te bllokimit të rrugëve të frymëmarrjes te fëmijët; - të përshkruajë masat pandaluese dhe pasojat e rënies të fëmijëve nga lartësiti; - të përshkruajë masat pandaluese dhe pasojat nga goditjet e fëmijëve me objekte të forta; - të përshkruajë masat pandaluese dhe pasojat e dëmtimeve të fëmijëve nga objekte të mprehta; - të përshkruajë masat pandaluese dhe pasojat e dëmtimeve të fëmijëve nga rryma elektrike; - të përshkruajë masat pandaluese dhe pasojat e dëmtimeve të fëmijëve nga helmimet; - të përshkruajë masat pandaluese dhe pasojat e dëmtimeve të fëmijëve nga mbytja në ujë; - të përshkruajë masat pandaluese dhe pasojat e dëmtimeve të fëmijëve nga “pika e diellit”; - të përshkruajë masat pandaluese dhe pasojat e dëmtimeve të fëmijëve nga pickimi i insekteve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim	

RN 2 Kursanti parandalon rreziqet te fëmijët dhe jep ndihmën e parë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të krijojë një mjedis të mbrojtur dhe të sigurtë për qëndrimin e fëmijëve;
- të tregojë si zhblllokohen rrugët e frymëmarrjes te fëmijët;
- të fiksojë gjymtyrët e dëmtuar ose të thyer të fëmijëve (në manekin);
- të kryejë veprimet e duhura për të pakësuar pasojat e goditjeve nga objekte të forta te fëmijët;
- të tregojë si pengohet rrjedhja e gjakut nga hundë, te fëmijët;
- të tregojë si veprohet për pakësimin e pasojave të djegieve te fëmijët;
- të tregojë si veprohet për pakësimin e pasojave të goditjes nga rryma elektrike te fëmijët;
- të kryejë frymëmarrja artificiale te fëmijët;
- të veprojë për pakësimin e pasojave të helmimeve te fëmijët;
- të tregojë për pakësimin e pasojave të mbytjes në ujë të fëmijëve;
- të tregojë si veprohet për pakësimin e pasojave të dëmtimit të fëmijëve nga “pika e diellit”;
- të shpjegojë përdorimin e paisjeve të kutisë së ndihmës së shpejtë;
- të përdorë paisjet të kutisë së ndihmës së shpejtë;
- të përshkruajë rëndësinë e paisjeve të çantës së kujdestares;
- të përdorë paisjet e çantës së kujdestarit;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe higjienës;
- të zbatojë rregullat e komunikimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Kursanti përshkruan simptomat e sëmundjeve më të shpeshta të fëmijëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë farmacinë e shtëpisë dhe tregojë si ruhen dhe administrohen ilaçet e fëmijëve;
- të tregojë pasojat nga temperatura e lartë te fëmijët;
- të përshkruajë simptomat dhe masat për parandalimin e saj;
- të përshkruajë simptomat e masat për parandalimin e gripit stinor;
- të tregojë pasojat nga gripi stinor;
- të përshkruajë pasojat nga diarrea;
- të përshkruajë pasojat nga të vjellat dhe masat për parandalimin e tyre;
- të përshkruajë pasojat nga laringiti;
- të përshkruajë pasojat nga dhimbja e veshit;

- të përshkruajë pasojat nga dhimbja e barkut;
- të përshkruajë pasojat nga konstipacioni (kapsllëku);
- të përshkruajë pasojat nga rrjedhja e gjakut nga hundët;
- të përshkruajë simptomat, parandalimin, masat, trajtimin dhe kurimin e parazitëve të zorrëve;
- të shpjegojë infeksionet e syve;
- të shpjegojë sëmundjet e gojës;
- të shpjegojë procesin e daljes së dhëmbëve, kujdesin dhe trajtimin e tyre;
- të përshkruajë simptomat e variçelës (lisë së dhenëve);
- të përshkruajë shenjat dalluese të shytave;
- të përshkruajë shenjat dalluese dhe masat në trajtimin e skarlatinës;
- të përshkruajë shenjat dalluese të fruthit;
- të përshkruajë simptomat e robeolës;
- të përshkruajë bronkitin dhe pneumoninë te fëmijët;
- të përshkruajë shenjat dalluese të hepatitit;
- të përshkruajë shenjat dalluese të meningjitit;
- të përshkruajë çfarë është vaksinimi;
- të tregojë kujdesin e duhur pas vaksinimit të fëmijëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RN 4 Kursanti jep ndihmën e parë për sëmundjet e shpeshta të fëmijëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të krijojë një mjedis të shëndetshëm gjatë mbajtjes së fëmijëve;
- të shpjegojë përdorimin e ilaçeve te fëmijët;
- të kryejë sterilizimin e termometrit;
- të përdorë termometrin te fëmijët;
- të kryejë banjo me ujë të vakët për ulje temperaturë te fëmijët;
- të përdorë kompresa te fëmijët;
- të kryejë banjo me avull për fëmijën;
- të përdorë ilaçe me pika, në vesh;
- të përdorë pompën për fëmijët që vuajnë nga astma;
- të pastrojë hundën e fëmijës me pompë;
- të përdorë aparatit aerosolit;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe higjienës;
- të zbatojnë rregullat e komunikimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime të përkujdesjes për fëmijët. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra, si: krijimin e një mjedisi të sigurtë për fëmijët, dhënien e ndihmës së parë. - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kusantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedisë reale të punës. - Mjedisë për përkujdesjen ndaj fëmijëve. - Mjetet e nevojshme për parandalimin apo dhënien e ndihmës së parë. - Kutia e ndihmës së shpejtë. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

6. Moduli “Zhvillimi dhe edukimi i fëmijëve”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ZHVILLIMI DHE EDUKIMI I FËMIJËVE	KF-06-24
Qëllimi i modulit	Një modul që njeh kursantët me procesin e zhvillimit psikomotor dhe shoqëror të fëmijëve 0-6 vjeç, si dhe aftëson ata për të mbështetur zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve, menaxhon rastet e bullizmit, organizon lojra dhe shëtitje për fëmijët.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori; 60% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për prani	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet: “Hyrje në profesionin e kujdestarit të fëmijëve”, “Veshja dhe higjiena e fëmijës”, “Ushqyerja e fëmijëve”, “Fjetja e fëmijëve” dhe “Mbrojtja e fëmijëve nga sëmundjet dhe rreziqet e mundshme”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Kursanti përshkruan procesin e zhvillimit psikomotor dhe shoqëror të fëmijëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë se si zhvillohet te fëmijët, aftësia për të parë; - të përshkruajë se si zhvillohen te fëmijët, aftësitë për të lëvizur dhe ecur; - të përshkruajë se si zhvillohen te fëmijët, aftësitë për të folur dhe kuptuar; - të përshkruajë se si zhvillohen te fëmijët, aftësitë për të luajtur; - të realizojë disa lloje lojrash për zhvillimin e fëmijës; - të tregojë si zhvillohen te fëmijët, aftësitë për të njohur mjedisin; - të tregojë se si zhvillohen te fëmijët, konceptet sipas grupmoshave; - të përshkruajë gjendjet emocionale të fëmijëve; - të kryejë mënyrat e trajtimit të tyre (kënaqësia, gëzimi, trishtimi, frika, ankthi, dashuria, qarja, nervozizmi, xhelozia, agresiviteti, etj.); - të përshkruajë karakteristikat e zhvillimit shoqëror të fëmijëve (marrëdhëniet e fëmijës me të tjerët). Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje -përgjigje me shkrim
	RN 2	Kursanti përshkruan rëndësinë që ka edukimi shëndetshëm tek fëmijët. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë rëndësinë që ka për fëmijët, edukimi shëndetësor;
- të përshkruajë rolin e prindërve në edukimin e hershëm të fëmijëve;
- të përshkruajë rolin e edukatorëve në edukimin e hershëm të fëmijëve;
- të përshkruajë rëndësinë e fillimit të hershëm të edukimit mjedisor;
- të përshkruajë rëndësinë që kanë përrallat, tek edukimi i fëmijëve;
- të përshkruajë përdorimin e lojrave elektronike, ndikimin dhe edukimin e tyre në shëndetin e fëmijëve;
- të përshkruajë efektet e përdorimit dhe mospërdorimit të telefonave tek fëmijët;
- të përshkruajë rëndësinë e vizatimit në zhvillimin e fëmijës;
- të përshkruajë çfarë është temperamenti;
- të përshkruajë llojet e temperamenti;
- të shpjegojë përkatësinë gjinore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RN 3 Kursanti menaxhon rastet e bullizmit në zhvillimin e fëmijëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë bullizmin, format e bullizmit;
- të ndihmojë fëmijën, të përballojë situata bullizmi;
- të ndihmojë bullistin, të shmangë sjellje bullizuese;
- të rekomandojë vëzhguesin për forma të reagimit ndaj bullizmit;
- të tregojë mënyrat e menaxhimit të bullizmit nga kujdestari.
- të zbatojë rregullat e komunikimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Kursanti organizon lojra për zhvillimin e fëmijëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë

- të përshkruajë rëndësinë e lojrave dhe lodrave sipas grupmoshave;
- të krijojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e lojrave të ndryshme.
- të sigurojë mjetet e nevojshme për zhvillimin e lojrave;
- të realizojë lojra për zhvillimin shqisor të fëmijëve;
- të realizojë lojra për zhvillimin fizik të fëmijëve;
- të realizojë lojra për zhvillimin intelektual të fëmijëve;
- të realizojë lojra për zhvillimin e të folurit dhe të kuptuarit të fëmijëve, si dhe atë shoqëror;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe komunikimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Kursanti organizon shëtitje për fëmijët.**Kriteret e vlerësimit:**

Kursanti duhet të jetë i aftë

- të përshkruajë rëndësinë e shëtitjeve për fëmijët;
- të përshkruajë veçoritë e shëtitjes sipas grupmoshave;
- të përzgjedhë një mjedis të përshtatshëm për shëtitjen e fëmijëve;
- të përkujdeset gjatë shëtitjes së fëmijëve;
- të tregojë përmbajtjen e çantës së fëmijës, që i nevojitet për shëtitjen;
- të organizojë shëtitje me fëmijët;
- të shpjegojë rreziqet potenciale, që mundet të përballët fëmija gjatë shëtitjes;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe higjienës;
- të zbatojnë rregullat e komunikimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime kujdesi të fëmijëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra, si: të organizojë shëtitje për fëmijët dhe krijojnë lojra të ndryshme.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës.
 - Komplet i materialeve katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

7. Moduli “Zhvillimi i fëmijëve me nevoja të veçanta”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ZHVILLIMI I FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA	KF -07-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që aftëson kursantët me zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, për t’u siguruar një përkujdesje të përshtatshme dhe për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve.	
Kohëzgjatja e modulit	35 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet: “Hyrje në profesionin e kujdestarit të fëmijëve”, “Veshja dhe higjiena e fëmijës”, “Ushqyerja e fëmijëve”, “Fjetja e fëmijëve”, “Mbrojtja e fëmijëve nga sëmundjet dhe rreziqet e mundshme” dhe “Zhvillimi dhe edukimi i fëmijëve”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Kursanti kujdeset për zhvillimin e fëmijëve me çrregullim hiperaktiviteti. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë kuptimin e çrregullimit të hiperaktivitetit; - të përshkruajë shkaqet kryesore të çrregullimit të hiperaktivitetit; - të përshkruajë karakteristikat e fëmijëve me çrregullim hiperaktiviteti; - të përshkruajë format dhe ndikimin e çrregullimit të hiperaktivitetit në procesin e të nxënit; - të tregojë tiparet që i dallojnë fëmijët me çrregullimin e hiperaktivitetit nga fëmijët e tjerë; - të hartojë një plan edukativ në ndihmë të fëmijëve me hiperaktivitet; - të kujdeset për fëmijët me çrregullim hiperaktiviteti; - të organizojë shëtitje për fëmijet me çrregullim hiperaktiviteti; - të organizojë lojra për fëmijët me çrregullim hiperaktiviteti; - të kujdeset për higjenën e fëmijëve me çrregullim hiperaktiviteti; - të kujdeset për ushqyerjen e fëmijëve me çrregullim e hiperaktiviteti; - të kujdeset për dhënien e medikamenteve sipas rastit; - të menaxhojë sjelljet e fëmijëve me çrregullim hiperaktiviteti; - të integrojë fëmijët me çrregullim hiperaktiviteti në sfera të ndryshme sociale; - të zbatojnë rregullat e komunikimit me etikë profesionale. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Kursanti kujdeset për zhvillimin e fëmijëve me spektrin e autizmit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë cilat janë shkaqet kryesore të spektrit të autizmit;
- të përshkruajë karakteristikat e fëmijëve me spektrin e autizmit;
- të argumentojë ndikimet e spektrit të autizmit në fushat e ndryshme tek fëmija;
- të shpjegojë klasifikimin e niveleve të autizmit;
- të menaxhojë sjelljet problematike të fëmijëve me spektrin e autizmit;
- të hartojë një plan edukativ në ndihmë të fëmijëve me spektrin e autizmit;
- të kujdeset për fëmijët me spektrin e autizmit;
- të organizojë shëtitje për fëmijët me spektrin e autizmit;
- të organizojë lojra për fëmijët me spektrin e autizmit;
- të kujdeset për higjenën e fëmijëve me spektrin e autizmit;
- të kujdeset për ushqyerjen e fëmijëve me spektrin e autizmit;
- të kujdeset për dhënien e medikamenteve sipas rastit;
- të menaxhojë sjelljet e fëmijëve me spektrin e autizmit;
- të integrojë fëmijët me spektrin e autizmit në sfera të ndryshme sociale;
- të zbatojë rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Kursanti kujdeset për zhvillimin e fëmijëve me sindromën ‘down’.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë cilat janë shkaqet kryesore të sindromës ‘down’;
- të përshkruajë karakteristikat e fëmijëve me sindromën ‘down’;
- të argumentojë ndikimet e çrregullimit të sindromës ‘down’ në fushat e ndryshme tek fëmija;
- të shpjegojë si klasifikohet sindroma ‘down’;
- të shpjegojë problemet e zakonshme shëndetësore të fëmijëve me sindromën ‘down’;
- të kujdeset për fëmijëve të vegjël me sindromën ‘down’;
- të shpjegojë menaxhimin e sjelljeve problematike të fëmijëve me sindromën ‘down’;
- të hartojë një plan edukativ në ndihmë të fëmijëve me sindromën ‘down’;
- të kujdeset për fëmijët me sindromën ‘down’;
- të organizojë shëtitje për fëmijët me sindromën ‘down’;
- të organizojë lojra për fëmijët me sindromën ‘down’;
- të kujdeset për higjenën e fëmijëve me sindromën ‘down’;

- të kujdeset për ushqyerjen e fëmijëve me sindromën ‘down’;
- të kujdeset për dhënien e medikamenteve sipas rastit;
- të menaxhojë sjelljet e fëmijëve me sindromën ‘down’;
- të integrojë fëmijët me sindromën ‘down’ në sfera të ndryshme sociale;
- të zbatojë rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Kursanti menaxhon procesin e gjithëpërfshirjes te fëmijët.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë procesin e gjithëpërfshirjes te fëmijët;
- të shpjegojë rëndësinë e gjithëpërfshirjes për të gjitha palët;
- të shpjegojë faktorët që ndikojnë në procesin e gjithëpërfshirjes;
- të menaxhojë procesin e gjithëpërfshirjes te fëmijët;
- të tregojë mënyrat e nxitjes në procesin e gjithëpërfshirjes;
- të kryejë intergrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- të menaxhojë paragjykimet, stereotipet dhe diskriminimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe higjienës;
- të zbatojë rregullat e komunikimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime për kujdesin e fëmijëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t’u jepen detyra, si: të tregojë hap pas hapi format e kujdesit për fëmijët me spektrin e autizmit, sindromën ‘down’ dhe të bëjnë dallimin mes tyre.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës. - Komplet i materialeve, katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
---	---
